




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.
2-D/DPK	01-2851/14
Nr. i lag. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Dati
02	13.08.2014
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.08.2014, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK– 03-1701/14, për znj. Aida Lllolluni, Auditorë i Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, për shkak se zyrtarja e lartë publike ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK–03-1701/14, që për trajtim ka pas zyrtaren e lartë znj. Aida Lllolluni, Auditorë i Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.**

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtarja e lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si, Auditorë i Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, është identifikuar se ka të regjistruar një biznes private me emër N.SH “Conta” me nr biznesi 70692414 dhe ushtron edhe funksione tjetera në këtë veprimtari private si dhe është identifikuar si person i autorizuar në biznesin privat “Ekoing” SH.P.K, me nr 7022765, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 29.05.2014 e ka njoftuar zyrtaren e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.



Pas këtyre procedurave, znj. Aida Lllolluni, Auditorë i Brendshëm ne Ministrin e Zhvillimit Ekonomik, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar qe ti behet një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm te interesit.

Zyrtarët e Agjencisë ne takimin qe është mbajtur me, znj. Aida Lllolluni e kanë njoftuar me faktet qe posedon Agjencia, lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit ne ushtrim te funksionit publik, ndërsa, znj. Lllolluni është pajtuar me gjendjen dhe është zotuar se biznesi N.SH “Conta” nuk zhvillon aktivitetet dhe se ne afat sa me te shpejt do te bej ndryshimet e nevojshme edhe tek biznesi “Ecoing”shpk, do te largohet nga pozita e personit te autorizuar dhe do ta shmang situatën e mundshme te konfliktit te interesit.

Me datën 18.06.2014, znj. Aida Lllolluni , ka sjell ne Agjenci dokumentin zyrtar te lëshuar nga ARBK-ja ku dëshmohet se janë ber ndryshimet e kërkuara dhe se ne biznesin privat me emër N.SH “Conta” me nr biznesi 70692414, zyrtarja ne fjale ka autorizuar një person tjetër, ndërsa me datën 04.08.2014 ka sjell po ashtu dokumentin zyrtar te lëshuar nga ARBK-ja ku dëshmohet se janë ber ndryshimet e kërkuara dhe se ne biznesin privat me emër “Ekoing”SH.P.K, me nr 7022765, nuk është me person i autorizuar i këtij biznesi.

Vlerësojmë se zyrtarja e lartë publike ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit të interesit në të cilën ndodhej

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues )

Drejtore Hasan Preteni  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

